



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI
DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE

Ref. nr. 101 / 2146 / Dt. 14 / 12 /2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

UNIVERSITET PUBLIK "KADRI ZEKA" DHE DREJTORATI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - GJILAN
E lidhur më datë : 14.12.2020 ndërmjet:

- 1) Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, rr. "Zija Shemsiu" p.n.
 - Përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
 - Në tekstin e mëtejmë si UKZ
- 2) Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Rruga "Isa Boletini" p.n. Gjilan
 - Përfaqësuar nga drejtori, z. Selami Xhemaili
 - Në tekstin e mëtejmë si MSHMS(Tani e tutje, së bashku do tu referohemi si "Palët")

Neni1
Përkufizimet

Palët janë marrë vesh si më poshtë:

Palët – Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjilan janë palë nënshkruese të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, e cila marrëveshje përfshinë asistimin e një ekipi shëndetësor i cili gjatë ditës do të jetë prezent për një kohë të caktuar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan për të dhënë ndihmë dhe kontolle shëndetësore studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ në UKZ.

Marrëveshje Bashkëpunimi – nënkupton Marrëveshjen e mëposhtme me të gjitha anekse

Neni 2
Qëllimi

- a) Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të përcaktoj kushtet e bashkëpunimit ndërmjet palëve për prezencë të një ekipi shëndetësor për një kohe të caktuar me orar ditor gjatë ditëve të punës për të ofruar ndihmën e nevojshme për kontrollë shëndetësore për studentët, stafin akademik dhe administrativ të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan.
- b) DSH dhe MS obligohet po ashtu për sigurimin e aparaturës teknike, logistike dhe medicionale për kryerjen me sukses të obligimeve të marra.
- c) Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, obligohet të sigurojë një hapësirë të nevojshme për ekipin shëndetësorë duke i siguruar qasje të papenguar për realizimin e detyrave të kësaj marrëveshje.
- d) Universiteti po ashtu do të përkujdeset për sigurimin e kushteve higjeno – teknike dhe inventarizimin e hapësirës në zyrën e siguruar.

Neni 3
Kohëzgjatja

- a) Kjo Marrëveshje, do të jetë e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri sa palët ta shkëpusin marrëveshjen e tillë. Nëse asnjëra palë, nuk e ndërprenë bashkëpunimin 3 (tre) muaj apo 90 (nëntë dhjetë) ditë para përfundimit të periudhës pesë vjeçare, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme edhe për tre vite të tjera.
- b) Në rast se njëra palë dëshiron të shkëpus marrëveshjen, ajo duhet së paku tre (3) muaj para ta paralajmëroj palën tjetër se dëshiron ta shkëpusë marrëveshjen.
- c) Në rast të tillë, Palët që mbeten do të konsultohen për vazhdimësinë e zbatimit të kësaj Marrëveshje dhe do të nxjerrin së bashku një vendim të përbashkët me shkrim.


Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj.

Neni 5
Dispozita përfundimtare

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përbëhet nga 5 (pesë) nene dhe është shkruar në gjuhën shqipe, në tri kopje dhe është e nënshkruar nga palët më datë 14.12.2020.

UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor



DREJTORATI I SHMS
Z. Selami Xhemaili, Drejtëtor

